



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2354/17 Prot.

Tiranë, më 25.06.2026

VENDIM

Nr. 98 , datë 15.06.2026

**“PËR CAKTIMIN E PÛRKOHSHËM TË PROKURORIT LEDJANA SHKURTI NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 15.06.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Ledjana Shkurti në Prokurorinë pranë
Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2354 prot., datë 10.06.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me vendimet respektive me nr. 60, 61, 62 dhe 63, datë 13.03.2026, të Këshillit është miratuar caktimi i përkohshëm i prokurorëve Françesk Ganaj, Enkeleda Hoxha, Odeta Todorushi dhe Ledjana Shkurti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë 3 mujore e cila përfundon në datë 16.06.2026.
3. Drejtuesi i zyrës së Prokurorisë Tiranë me shkresën nr. 14118 prot., datë 25.05.2026, (administruar me tonën nr. 2232 prot., datë 26.05.2026), ka parashtuar kërkesën për përsëritjen e caktimit të përkohshëm të prokurorëve të sipërpërmendur duke argumentuar ndër të tjera, se:

“Prokurorët Ledjana Shkurti, ..., ushtrojnë detyrën në seksionin e “Krimet e rënda ndaj pronës, mjedisit dhe veprat penale ushtarake”, çka ka sjellë uljen e ngarkesës së çështjeve të prokurorëve të këtij seksioni në raport me seksionet e tjera, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e hetimit, ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të çështjeve në gjykatë.

Largimi i tyre në datë 16.06.2026 do të ndikonte drejtpërdrejtë dhe negativisht në funksionimin normal të seksionit në veçanti dhe të prokurorisë në përgjithësi, përse kohë që numri i prokurorëve që ushtrojnë detyrën në këtë prokurori është i njëjtë me atë që ishte në datën 13.03.2026 (kur është marrë vendimi i Këshillit të lartë të Prokurorisë) dhe vazhdon prania e “pozicioneve vakante përkohësisht” ku ata janë caktuar.”

4. Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 21 datë 22.01.2026 “Për caktimin e strukturës organike të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” ka përcaktuar numrin e prokurorëve në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe asaj të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nga Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, përcillet informacioni se në zyrën e Prokurorisë Tiranë ku, organika është e përbërë nga 90 prokurorë, aktualisht ka 20 vakanca të përhershme dhe 12 vakanca të përkohshme. Konkretisht, pranë kësaj zyre prokurorie ushtrojnë efektivisht detyrën 58 prokurorë (65%) (këtu nuk janë përfshirë 4 prokurorët e caktuar përkohësisht), nga të cilët një prokuror ushtron detyrën e drejtuesit, një prokuror ushtron detyrën e zëvendës drejtuesit, 6 prokurorë ushtrojnë detyrën e shefit të seksionit dhe në seksionin e ekzekutiveve të vendimeve, i cili nuk ushtron detyra hetimore, bëjnë pjesë 5 prokurorë.
5. Në vijim të diskutimit në Komision lidhur me ngarkesën e punës në zyrën e Prokurorisë Tiranë, në datë 04.06.2026, i është kërkuar rifreskim i informacionit drejtuesit të zyrës së Prokurorisë Tiranë, me qëllim vënien në dispozicion të anëtarëve me këtë relacion bashkëlidhur. Drejtuesi i zyrës së prokurorisë Tiranë, me e-mailin e datës 05.06.2026, ka

përcjellë Shkresën nr.14119/1 prot., datë 05.06.2026, me lëndë “Kthim përgjigje” (administruar me nr. 2298 prot., datë 05.06.2026), me informacionin, si vijon:

“... Ashtu si kemi cituar edhe në kërkesën e datës 03.06.2026, numri i kallëzimeve penale të referuara në Prokurori ka ardhur në rritje. Po ashtu vlen të theksohet fakti se largimet e prokurorëve në kuadër të procesit të vettingut kanë prekur edhe këtë seksion, pasi janë shortuar një numër i lartë procedimesh penale në hetim dhe gjykim të prokurorëve të larguar që i përkisnin këtij seksioni. Konkretisht, vetëm dy prokurorë të larguar së fundmi, kanë dorëzuar rreth 1200 materiale, kallëzime dhe procedime, të cilat janë shortuar midis prokurorëve të seksionit.

Performanca e ngarkesës në raport me përfundimin e çështjeve penale të katër prokurorëve ka qenë pozitive krahasuar me mesataren e seksionit.

Në mënyrë analitike, ngarkesa në punë e prokurorëve Françesk Ganaj, Odeta Todorushi, Enkeleda Hoxha dhe Ledjana Shkurti, për periudhën prill 2025 deri aktualisht është si më poshtë:

- *Prokurore Ledjana Shkurti ka marrë në total 687 materiale hetimore, ka përfunduar 522 materiale (mosfillime+procedime) dhe ka në hetim 154 procedime si dhe materiale në fazë verifikimi;*
-
- *Në raport me të dhënat e përgjithshme statistikore të seksionit, rezulton se mesatarisht çdo prokuror i seksionit ka përfunduar 443 materiale (mosfillime+procedime) dhe ka patur në hetim 165 procedime.*
- *Duke patur parasysh të dhënat e mësipërme, numrin e materialeve të trajtuara nga prokurorët e caktuar përkohësisht, si dhe numrin e procedimeve penale që kanë në hetim, mungesa e tyre në Prokurorinë e Tiranës, në seksionin “Për hetimin e krimeve kundër pronës, mjedisit dhe veprave penale ushtarake”, do të sillte rritje të konsiderueshme të ngarkesës për çdo prokuror tjetër të seksionit.”*

6. Nisur nga sa u parashtua më sipër, relatori, z. Sokol Stojani mbajti qëndrimin se, në kushtet e numrit të lartë të vakancave faktike, 32 të tilla, zyra e Prokurorisë Tiranë e cila ndër vite ka trajtuar 1/3 e çështjeve në rang vendi, mund të përballlet me disa problematika serioze si: ngarkesë e lartë për prokurorët që ushtrojnë funksionin në këtë zyrë; vonesa në hetim edhe procedime; ulje e cilësisë së hetimeve; vështirësi në përfaqësim në gjykatë; rrezik për tejkalim afatesh ligjore, etj.

Në këto kushte, relatori, propozoi aplikimin e instrumentit të “caktimit të përkohshëm” për prokurorët e sipërpërmendur me qëllim mosndërprerjen e punës, si dhe ruajtjen e funksionalitetit të zyrës së Prokurorisë Tiranë.

7. Aplikimi i këtij instrumenti tashmë është i miratuar nga Këshilli në vendimet nr. 60, 61, 62 dhe 63, datë 13.03.2026. Ashtu sikurse është miratuar edhe caktimi i përkohshëm i prokurorëve në pozicione konkrete, bazuar në analizën juridike të kryer në vendimet e

sipërpërmendura në zbatim të interpretimit të termit pozicion, sipas vendimeve të Gjykatës së Lartë (nr. 00-2020-955, datë 28.12.2020, nr. 00-2021-16, datë 08.01.2021 dhe nr. 00-2021-15 (4), datë 18.01.2021) duke mundësuar kështu, saktësimin e shkakut të caktimit, afatin, marrëdhënien juridike në rast të rikthimit të magjistratit që mban pozicionin në mënyrë të përhershme, si dhe pasojat juridike, në të ardhmen, në rast të ndryshimit të natyrës së pozicionit konkret nga i përkohshëm në të përhershëm.

8. Propozimi i relatorit bazohet në pikën 2, të nenit 42, dhe nenin 59 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim *Ligji për Statusin*), si dhe nenin 3, të Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, ku parashikohet:

“Neni 42

Parimet e transferimit

.... 2. Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, **për të paktën 3 muaj**, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”

“Neni 59

Caktimi i përkohshëm

1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë **jo më shumë se tre muaj**, për shkak të:

- a) caktimit në pozicione të tjera,
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.**

“Neni 3

Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve

- 1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.
- 2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.

9. Në përfundim, duke vlerësuar funksionalitetin e zyrës së Prokurorisë Tiranë dhe vazhdimësinë e ndjekjes së procedimeve penale nga prokurorët Françesk Ganaj, Enkeleda Hoxha, Odeta Todorushi dhe Ledjana Shkurti, Relatori propozoi:

- 1.
- 2. Caktimin e përkohshëm për një periudhë 3 mujore të prokurores Ledjana Shkurti në zyrën e prokurorisë Tiranë, në pozicionin vakant të përkohshëm që i përket prokurores Lindita Ziguri, e komanduar aktualisht në zyrën e ILD-së.

10. Çështja e kompensimit mujor për prokurorin që transferohet përkohësisht me pëlqim parashikohet në nenin 15, pikat 2 dhe 3, të Ligjit për Statusin, si dhe Rregulloren “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”.
11. Anëtarja e Komisionit, znj. Ledina Riza, shprehet në parim dakord për vijimin e ushtrimit të detyrës së prokurorëve Françesk Ganaj, Enkeleda Hoxha, Odeta Todorushi dhe Ledjana Shkurti pranë zyrës së Prokurorisë Tiranë, për shkak se, nisur nga nevojat e paraqitura në shkresën e drejtuesit të kësaj zyre prokurorie, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Burimeve Njerëzore, numrit aktual të prokurorëve në detyrë (58 nga 90 në total që është numri i miratuar i organikës së zyrës së prokurorisë Tiranë), si dhe ngarkesës së punës, identifikohet nevoja për të patur edhe në vijim magjistratë të caktuar përkohësisht së paku deri në transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele të një numri të caktuar prokurorësh nga procedurat administrative që janë në vijim. Znj. Riza shprehet se, çmon që instrumentit i “*caktimit të përkohshëm*” duhet aplikuar nga Këshilli në raste të jashtëzakonshme prandaj i qëndron mendimit të shprehur më herët që instrumenti i duhur është ai i “*transferimit të përkohshëm me pëlqim*”.
12. Lidhur me sa më sipër, Kryetarja e Komisionit, znj. Mirela Bogdani mbajti qëndrimin se, në respektim edhe të praktikës së fundit (praktika që lidhet me transferimet e përkohshme me pëlqim në Prokurorinë Elbasan, të kryera nga Këshilli në datë 09.12.2025), Këshilli duhet të shpallë procedurën për plotësimin e 5 (pesë) vendeve vakante përmes transferimit të përkohshëm me pëlqim, për një vit, në zyrën e prokurorisë Tiranë, duke ftuar të gjithë prokurorët e interesuar të shprehin interesin.
13. Lidhur me propozimet e mësipërme, Komisioni propozoi që Këshilli të vendosë se cili do të jetë instrumenti më i përshtatshëm për trajtimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për përsëritjen e caktimit të përkohshëm për prokurorët Françesk Ganaj, Enkeleda Hoxha, Odeta Todorushi dhe Ledjana Shkurti në këtë zyrë të prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 15, pikat 2 dhe 3 dhe 59, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Vendimin nr. 386, datë 30.11.2023, “Për miratimin e rregullores “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Ledjana Shkurti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant përkohësisht që i përket prokurorit Lindita Ziguri, aktualisht i komanduar në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Prokurori Ledjana Shkurti do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri në datën 16.09.2026.
3. Të njoftohen me këtë vendim prokurori Ledjana Shkurti, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 15.06.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani
(kundër)

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda
(kundër)

ANËTAR
Ledina Riza
(kundër)

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla
(kundër)

MENDIM PAKICE

1. Ne anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kemi votuar “kundër” vendimit “Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Ledjana Shkurti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, duke mos u bashkuar me *qëndrimin e shumicës*, pasi vlerësojmë se ky vendim përbën zbatim të gabuar, të hapur dhe të përsëritur të instrumentit të “*caktimit të përkohshëm*”, në kundërshtim me ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Përmes këtij mendimi pakice, parashtrojmë arsyet ligjore, përse e konsiderojmë të pabazuar këtë vendimmarrje të Këshillit.
2. Si fillim, theksojmë se qëndrimi ynë “kundër” nuk lidhet në asnjë mënyrë me emrin konkret të prokurorit të *caktuar përkohësisht*, as me aftësinë, integritetin, performancën apo vullnetin e saj për të kontribuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Çështja është tërësisht e lidhur me parashikimet ligjore, interpretimin e gabuar të tyre dhe me mënyrën se si Këshilli po përdor një instrument të jashtëzakonshëm dhe të kufizuar në kohë, duke e shndërruar atë në një mekanizëm të zakonshëm, të përsëritur dhe praktikisht të pakufizuar për menaxhimin e vakancave në prokurori.
3. Në vlerësimin tonë, ky vendim tregon një keqkuptim serioz të nenit 59 të ligjit për Statusin, të strukturës së ligjit dhe të dallimit ndërmjet instrumenteve të ndryshme të transferimit të magjistratëve.

I. Caktimi i përkohshëm sipas nenit 59 nuk mund të përdoret për mungesa shumëvjeçare

4. Neni 59 i ligjit për Statusin ndodhet në kreun që rregullon “mandatin e kufizuar”. Kjo vendosje sistematike tregon se *caktimi i përkohshëm* nuk është parashikuar si instrument i zakonshëm për plotësimin e mungesave strukturore apo afatgjata të prokurorive. Ai është konceptuar si mekanizëm kalimtar, i kufizuar në kohë, për raste kur magjistrati që mban pozicionin në mënyrë të përhershme nuk është në gjendje ta ushtrojë funksionin për një periudhë të shkurtër dhe të përcaktuar jo më shumë se tre muaj, për shkak të caktimit në pozicione të tjera apo arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.
5. Në rastin konkret, pozicioni ku caktohet prokurori Ledjana Shkurti identifikohet si pozicioni që i përket prokurorit Lindita Ziguri, i komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky nuk është rast i një mungese të shkurtër, të paparashikuar apo 3 (tre)-muajore. Komandimi si inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është komandim për një mandat të plotë 5 (pesë)-vjeçar. Për këtë arsye, trajtimi i këtij pozicioni si *vakancë* që mund të mbulohet vazhdimisht përmes *caktimeve të përkohshme* 3 (tre)-muajore, është në kundërshtim të hapur me qëllimin e nenit 59.
6. Këshilli nuk mund ta shmangë kufirin ligjor duke e ndarë një situatë afatgjatë në periudha të përsëritura 3-mujore. Në formë, vendimi respekton afatin tre-mujor, ndërsa në substancë, ai e

përdor nenin 59 për të mbuluar një mungesë shumëvjeçare. Ky është përdorim formalist dhe abuziv i ligjit.

7. Nëse pranohet kjo qasje, kufiri kohor i nenit 59 bëhet i pavlefshëm në praktikë, sepse Këshilli mund të ripërtërijë të njëjtin caktim çdo tre muaj, pa fund, pa procedurë dhe pa iu drejtuar instrumenteve të tjera të parashikuara nga ligji. Kjo përbën shkelje të rëndë dhe të përsëritur të ligjit.

II. Vendimi është marrë pa procedurën që kërkon ligji

8. *Caktimi i përkohshëm*, edhe kur është i lejuar, nuk mund të bëhet në mënyrë të mbyllur, të drejtpërdrejtë dhe pa asnjë procedurë. Neni 59, në paragrafin 9 të tij, kërkon që të ketë rregulla për njoftimin dhe plotësimin e vendeve të lira të përkohshme. Kjo nënkupton transparencë, mundësi shprehjeje interesi dhe vlerësim të kandidatëve potencialë, për aq sa e lejon natyra e instrumentit.
9. Në rastin konkret, nuk rezulton të jetë bërë thirrje e hapur për shprehje interesi. Nuk rezulton të jenë identifikuar kandidatë të mundshëm. Nuk rezulton të jetë bërë krahasim ndërmjet prokurorëve të interesuar dhe nuk rezulton të jenë zbatuar kritere objektive për përzgjedhjen. Këshilli ka kaluar drejtpërdrejt: nga kërkesa e drejtuesit të Prokurorisë Tiranë, te përsëritja e caktimit të mëparshëm.
10. Urgjenca nuk e përjashton ligjin. Ajo mund të justifikojë veprim të shpejtë, por jo veprim jashtë procedurës. Për më tepër, në këtë rast nuk jemi më në momentin fillestar të një nevojë të papritur. Caktimi i parë kishte një afat tre-mujor, gjatë të cilit Këshilli kishte kohë të mjaftueshme për të nisur procedurën e duhur ligjore.

III. Instrumenti i duhur ishte transferimi i përkohshëm me pëlqim

11. Ligji për Statusin parashikon disa instrumente të ndryshme për adresimin e nevojave të prokurorive. Këshilli nuk mund të zgjedhë instrumentin më të lehtë administrativisht, duke anashkaluar atë që i përgjigjet natyrës reale të situatës.
12. Në rastin konkret, pas caktimit të parë 3-mujor, Këshilli kishte mundësinë dhe detyrimin të shqyrtonte menjëherë instrumentin e *transferimit të përkohshëm me pëlqim*, për një periudhë deri në një vit. Ky instrument është më i përshtatshëm për situata që nuk janë thjesht emergjente dhe momentale, por kërkojnë një zgjidhje më të qëndrueshme, me procedurë, me shprehje interesi dhe me kritere të qarta.
13. Vetë fakti që në Komision është diskutuar nevoja për shpalljen e procedurës së *transferimit të përkohshëm me pëlqim* tregon se ekzistonte një alternativë ligjore më e përshtatshme. Mosndjekja e kësaj rruge dhe përsëritja e nenit 59 krijon përshtypjen se Këshilli nuk ka vepruar për shkak të një urgjence të pashmangshme, por për shkak të një zgjedhjeje të gabuar dhe të përsëritur, për të anashkaluar procedurat e rregullta.
14. Nëse situata e Prokurorisë Tiranë ishte urgjente në muajin mars, ajo mund të justifikonte vetëm një ndërhyrje fillestare dhe të kufizuar. Pas kalimit të tre muajve, Këshilli nuk mund të

pretendojë më të njëjtën urgjencë, për të vazhduar të përdorë të njëjtin instrument të jashtëzakonshëm.

15. *Caktimi i përkohshëm* duhet të mbetet instrument për raste përjashtimore. Përdorimi i tij i përsëritur, pa afat real përfundimi dhe pa një plan të qartë për kalimin te instrumentet e rregullta, cenon sigurinë juridike, transparencën dhe parashikueshmërinë në administrimin e karrierës së prokurorëve.
16. Kjo qasje bie ndesh edhe me orientimet e fundit europiane mbi nevojën për kufizimin e përdorimit të instrumenteve të përkohshme si mjete për mbushjen e vakancave. Në rekomandimet e muajit mars 2026, Komisioni Evropian ka theksuar, se: KLGJ ftohet “*të forcojë transparencën e transferimeve paralele dhe të kufizojë përdorimin e kësaj procedure si mjet i përkohshëm për plotësimin e vakancave, në vend të ngritjeve në detyrë të bazuara në meritë*”. Edhe pse ky rekomandim i drejtohet KLGJ-së dhe lidhet me kontekstin e *transferimeve paralele*, parimi që qëndron pas tij është plotësisht i zbatueshëm edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë: instrumentet e përkohshme nuk duhet të përdoren për të zëvendësuar procedurat e rregullta, transparente dhe të bazuara në meritë.
17. Në rastin konkret, Këshilli po bën pikërisht atë që standardet europiane kërkojnë të shmangët: po përdor një mekanizëm të përkohshëm për të administruar një nevojë strukturore dhe të parashikueshme, në vend që të hapë procedura të rregullta dhe transparente.
18. Nuk vihet në dyshim se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka ngarkesë të lartë pune dhe nevojë për mbështetje. Nuk vihet në dyshim as rëndësia e garantimit të funksionalitetit të kësaj zyre.
19. Por, nevoja institucionale nuk mund të përdoret për të justifikuar shkeljen e ligjit. Përkundrazi, sa më serioze të jetë nevoja, aq më i detyruar është Këshilli të zgjedhë instrumentin e duhur ligjor. Nëse mungesa është afatgjatë, zgjidhja duhet të jetë e tillë. Nëse nevoja kërkon plotësim më të qëndrueshëm, Këshilli duhet të përdorë *transferimin e përkohshëm, lëvizjen paralele* ose instrumentet e tjera të parashikuara nga ligji, jo të përsërisë pafund *caktime të përkohshme* 3 (tre)-muajore.
20. Përdorimi i nenit 59 në këtë mënyrë, nuk zgjidh problemin strukturor të Prokurorisë Tiranë. Ai thjesht e zvarrit atë dhe, ndërkohë, krijon një precedent të rrezikshëm për administrimin e karrierës së prokurorëve.
21. Për arsyet e mësipërme, kemi votuar “*kundër*” vendimit për *caktimin e përkohshëm* të prokurorit Ledjana Shkurti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
22. Në vlerësimin tonë, vendimi:
 - a. zbaton në mënyrë të gabuar dhe të hapur nenin 59 të ligjit për Statusin;
 - b. trajton si situatë tremujore një mungesë që lidhet me një mandat pesëvjeçar në ILD;
 - c. përdor instrumentin e caktimit të përkohshëm jashtë qëllimit për të cilin është krijuar;
 - d. shmang thirrjen e hapur, shprehjen e interesit dhe vlerësimin e kandidatëve;
 - e. anashkalon instrumentin më të përshtatshëm të transferimit të përkohshëm me pëlqim;
 - f. përsërit një praktikë të gabuar dhe të paligjshme;

- g. krijon rrezik për shndërrimin e një instrumenti përjashtimor në mekanizëm të zakonshëm administrimi të vakancave;
 - h. cenon ligjshmërinë, transparencën dhe parashikueshmërinë në administrimin e karrierës së prokurorëve.
23. Ky vendim, në vlerësimin tonë, përbën shkelje të rëndë, të hapur dhe të përsëritur të ligjit nga shumica vendimmarrëse e Këshillit. Ai reflekton mungesë serioze të kuptimit të instrumenteve të transferimit të parashikuara në ligjin për Statusin dhe krijon një precedent të rrezikshëm për përdorimin e nenit 59, si mjet të përgjithshëm për menaxhimin e mungesave afatgjata në prokurori.

ANËTAR

Erion Fejzulla

ANËTAR

Zeqir Hoda